



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_.\_\_.2025

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE QË RIORGANIZOHEN SIPAS LIGJIT PËR  
INSPEKTIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 3, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Institucionet me funksione inspektimi në juridiksionin ekzekutiv të qeverisjes qendrore, në fushën e zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të cilat i nënshtrohen procesit të riorganizimit, janë si më poshtë:
  - a) Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar;
  - b) Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
  - c) Agjencia Kombëtare e Bregdetit;
  - ç) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
  - d) Agjencia Kombëtare e Pyjeve;
  - dh) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
  - e) Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;
  - ë) Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
  - f) Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
  - g) Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës;
  - gj) Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës;
  - h) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
  - i) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore;
  - j) Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
  - k) Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;

- l) Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
  - m) Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet;
  - n) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren/Sektori i Inspektimit në Terren).
2. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe institucionet e përcaktuara në pikën 1, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**

**Edi Rama**